



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

1. Seancë dëgjimore me drejtuesin e Akademisë së Sigurisë, lidhur me procesin e rekrutimit të studentëve që kanë përfunduar universitetin me rezultate të larta dhe që dëshirojnë të bëhen pjesë e Policisë së Shtetit, si dhe programi i punës së Akademisë së Sigurisë për vitin 2019.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Elona Hoxha, Paulin Sterkaj, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Myslim Murrizi, Ervin Saliangji, Flamur Noka, Endrit Braimllari, Adnor Shameti dhe Xhemal Gjunksi.

Mungojnë:

Isuf Çelaj, Luan Rama, Luan Duzha, Andon Frrokaj, Pjerin Ndreu dhe Elena Xhina.

Të ftuar:

Bilbil Memaj - Rektor i Akademisë së Sigurisë

Nikollë Rica- Drejtor i Burimeve Njerëzore

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës të mbledhjes së këtij komisioni kemi parashikuar seancë dëgjimore me drejtuesin e Akademisë së Sigurisë, zotin Bilbil Memaj.

Faleminderit, zoti Memaj që jeni i pranishëm në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare!

Gjithashtu, i pranishëm është edhe zoti Nikollë Rica, drejtor i Burimeve Njerëzore.

Faleminderit, zoti Rica!

Komisioni i Sigurisë planifikoi që ta zhvillonte këtë seancë dëgjimore me Akademinë e Sigurisë nisur nga fakti se kjo e fundit si një ndër institucionet publike të arsimit të lartë në fushën e përgatitjes së të gjithë punonjësve të rinj të policisë, është shumë e rëndësishme për ne si anëtarë të këtij komisioni. Arsimimi nëpërmjet kurrikulave dhe programeve bashkëkohore të të gjithë atyre që aplikojnë për t'u bërë pjesë e Akademisë së Sigurisë, është shumë i rëndësishëm, sepse siguron të kemi kapacitete të mira njerëzore në Policinë e Shtetit, por nga ana tjetër bën të mundur edhe një karrierë profesionale të qëndrueshme.

Për t'u njohur më tepër me programet, me kurrikulën e Akademisë së Sigurisë që ju drejtoni, por për t'u njohur edhe me një proces të fundit që ka shpallur akademia lidhur me studentët që kanë mbaruar ndërkohë në degë të tjera të arsimit të lartë publik, por që aplikojnë për t'u bërë pjesë e Akademisë së Sigurisë, do të doja të kishim një prezantim nga ana juaj.

Më pas procedura e funksionimit të këtij komisioni, është ajo normale, pavarësisht se është një seancë dëgjimore. Pas dëgjësës anëtarët e këtij komisioni kanë të drejtë sipas rregullores së punës së komisioneve parlamentare të drejtojnë pyetje. Në përfundim të pyetjeve dhe marrjes së përgjigjeve, do të bëhen edhe diskutimet lidhur me këtë dëgjësë.

Faleminderit, edhe një herë për prezencën!

Fjala është për ju, zoti Memaj.

Bilbil Memaj- Faleminderit!

Për mua dhe për institucionin që drejtoj është nder që na u dha mundësia të paraqesim para jush punën që po bën Akademia e Sigurisë për shkollimin, trajnimin e

Policisë së Shtetit, por jo vetëm dhe për të gjitha institucionet e tjera që merren me sigurinë e brendshme, sigurinë publike në Shqipëri.

Unë do të flas shkurtimisht, sepse jam i bindur që nëpërmjet pyetjeve tuaja do të plotësoj atë që ju keni më shumë interes për të ditur rreth Akademisë së Sigurisë. Në kërkesën tuaj interesi juaj është shprehur vetëm për dy gjëra: për rekrutimet e fundit në bazë të ndryshimit të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, si edhe për sa i përket programit të akademisë për vitin 2019.

Akademia e Sigurisë është rindërtuar, rihapur në vitin 2015, pas një periudhe të gjatë të mbylljes së saj në nivelet e arsimit të lartë. Prej 10 vjetësh në akademi nuk ka pasur arsim të lartë, ka pasur vetëm arsim bazë, nga ku dilnin inspektorët e Policisë së Shtetit, që janë niveli i parë dhe përbëjnë bazën e Policisë së Shtetit. Në vitin 2015 si rezultat i një mangësie, vakumi të madh që u krijua me gradat “nënkomisar” të Policisë së Shteti dhe të uljes së performancës së kësaj grade, të këtij niveli të oficerëve të policisë, u gjykua të rihapej akademia me një vizion tjetër nga ish- Akademia e Policisë në një Akademi Sigurie, me një program të ri, i cili do të ishte i nevojshëm për të plotësuar këto kërkesa që përmenda më sipër.

Akademia u hap në vitin 2015 me 3 njësi kryesore: me Fakultetin e Sigurisë dhe të Hetimit, me shkollën bazë të policisë, i quajtur Kolegji Policor, me një njësi Kërkimore Shkencore që merret me hulumtime, kërkime në fushën e sigurisë publike dhe botime për këtë kërkim. Të tria këto njësi u vunë në punë gjatë këtyre viteve dhe ne kemi nxjerrë vitin që kaloi brezin e parë të studentëve që kanë mbaruar bachelor në siguri dhe hetim. Këtë vit kemi brezin e dytë. Ndërtimi i njësive kryesore të akademisë është bërë në përputhje me ish- ligjin “Për arsimin e lartë”. Pastaj ne e konvertuam “Programe në ligjin e ri të arsimit të lartë”. Të gjitha departamentet që përbëjnë fakultetin janë në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë” dhe të gjitha institucionet që ka akademia janë në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë”. Në akademi vepron senati, njësitë e tjera sipas rregullave në përputhje me statutin e akademisë, i cili është miratuar nga ministrja e Arsimit dhe ministri i Brendshëm.

Programet e akademisë miratohen nga ministri i Arsimit dhe nga ministri i Brendshëm. Dy janë varësitë e Akademisë: nga linja teknike që është ajo e policisë, nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe ministri i Brendshëm. Për sa u përket programeve, ndjekjes së tyre, mënyra se si zbatohen ato bëhet nga ana e ministrit të Arsimit.

Nga momenti që është hapur akademia dhe deri tani kemi: programin bachelor për sigurinë publike dhe hetimin. Kemi dy programe master profesional, një për sigurinë dhe një

për hetimin. Kemi program të nivelit të shkollimit bazë. Pastaj janë të gjitha programet e kualifikimeve dhe të specializimeve të policisë që në total përbëjnë 60 të tilla. Akademia nga viti 2015 deri tani ka 60 programe të miratuara me kurrikul të veçantë. Të gjitha këto programe frekuentohen nga Policia e Shtetit, nga Garda e Republikës, nga Policia Bashkiake, nga Policia e Burgjeve, por peshën kryesore e zë Policia e Shtetit, pasi ka edhe numrin më të madh të punonjësve.

Në programin bachelor jepet diplomë trevjeçare për sigurinë dhe për hetimin sipas sistemit të Bolonjës dhe në programin master jepet diplomë për masterin profesional, diplomë për sigurinë publike dhe për masterin e hetimit, hetues në Policinë e Shtetit.

Jemi duke punuar për të çelur edhe programe të tjera, pasi ligji që keni kaluar kohët e fundit në dhjetor të vitit të kaluar na detyron që deri në gradat e menaxherëve që kanë këto institucione të specializohen edhe në programe. Ne po punojmë që të zbatojmë tashmë ligjin që Policia e Shtetit të ketë program më vete, Policia Kufitare program më vete, sepse kështu na detyron ligji i ndryshuar.

Për sa u përket gradave të larta po punojmë për kurrikula menaxheriale. Të gjitha gradat e policisë i përkasin një programi, kurrikul më vete në Akademinë e Sigurisë. Çdo person që do të marrë një gradë është i detyruar të ndjekë një kurs të programuar me kurrikul të veçantë në akademi. Në sistemin që kemi ndërtuar, afërsisht janë 42 muaj në total, që duhet të kalojë një punonjës i policisë për të marrë gradën madhore, për të qenë në gradën më të lartë të Policisë së Shtetit, këtu futen shkollime, trajnime dhe specializime.

Për sa i përket rolit bazë, inspektorëve të policisë, ata nuk mjaftohen vetëm me 9 muaj shkollë, shkolla bazë, pasi aty dalin patrullë e përgjithshme dhe janë të detyruar të punojnë në këtë profesion, por nëse ata do të ndryshojnë profilin, nëse do të shkojnë në shërbimin e Policisë Kufitare ata janë të detyruar të vijnë përsëri në akademi dhe të bëjnë një kurs tremujor të specializuar. Këto kurse janë të miratuara me kurrikul të veçantë.

Meqenëse jemi këtu po ju them se të gjitha kurset që kanë të bëjnë me Policinë Kufitare, tashmë po i unifikojmë me *Frontex*-in, pasi Akademia e Sigurisë e Shqipërisë është bërë partnere e rrjeteve të *Frontex*-it vitin e kaluar.

Në programet që kemi ndjekur, gjëja kryesore që kemi pasur parasysh ka qenë orientimi drejt programeve dhe kurrikulave që ka CEPOLI që është Kolegji Europian i akademive të vendeve të BE-së. Duke qenë shumë të lidhur me këtë institucion, ne po implementojmë kurrikulat e tyre dhe shpeshherë konsultohemi me ta, jo vetëm kaq, por kemi

bërë të mundur që edhe pedagogë të akademive të vendeve të BE-së të japin mësim në akademinë tonë.

Përveç kësaj kemi bërë marrëveshje bashkëpunimi me shumë nga akademitë e vendeve të BE -së, por edhe të vendeve të rajonit, ku do të përmendja Akademinë e Austrisë, të Estonisë dhe të shumë vendeve të rajonit, pasi jemi në një *network* me vendet e rajonit për shkak të lidhjes që po krijojmë për të shkëmbyer eksperiencë, por bashkëpunimin më të ngushtë e kemi me Akademinë e Hungarisë, e cila është edhe një akademi tutore për ne, për sa i përket ndjekjes së programeve të kurikulave të kualifikimit që po bëjmë.

Deri tani mendojmë se kemi ndikuar në rritjen e performancës së punonjësve të policisë dhe po kërkojmë të rrisim cilësinë e programeve dhe të mësimdhënies, po kështu edhe të specializimeve të veçanta.

Ligji që ju ndryshuat si ligjvënës për të futur shtetas që kanë mbaruar master dhe që janë ekselentë në policisë mendoj se do të ndikojë pozitivisht në nivelin profesional, jo vetëm, por edhe në kulturën e përgjithshme, si dhe do të rregullojë shumë faktorë të cilët duke e ndihmuar njëri-tjetrin mund të rrisim edhe performancën e policisë në përgjithësi.

Për sa i përket kësaj futjeje të re në polici, në bazë të ligjit të ndryshuar, meqenëse hyri në fuqi në datën 31 janar, më 1 shkurt ne hapëm portalin e akademisë dhe përgatitëm të gjithë dokumentacionin përkatës që buronte nga pjesa e ligjit. Ka dalë urdhi i ministrit të Brendshëm për kriteret e veçanta, i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për procedurën sesi do të ndiqet konkursi. Është përgatitur portali i akademisë dhe ka funksionuar që në datën 1 shkurt. Tani mund t'ju them se janë 400 aplikime në portalin e akademisë, por edhe në komisariate, në drejtoritë e qarqeve për 150 vende që ne kemi shpallur si vende vakant në polici.

Nuk jam në gjendje të them për nivelin e këtyre aplikimeve, pasi ne nuk i kemi hapur ato, sepse deri në datën 15 do të presim të bëhen aplikimet e tjera. Në këtë datë do të mbyllem aplikimet dhe komisioni i ngritur nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ku janë pedagogë të akademisë, do të merret me përzgjedhjen në bazë të një formule, të cilën e kemi miratuar. Do të ndiqen hapat e tjerë, ku hapi i dytë është niveli i gjuhës angleze dhe i gjuhëve të tjera, do të merret mesatarja e tyre. Pastaj do të jenë: kontrolli fizik, kontrolli mjekësor dhe kriteret e përgjithshme, të cilat duhet t'i plotësojë çdo shtetas për t'u bërë oficer policie. Mendojmë se në datën 1 mars kemi filluar kursin për daljen oficer të këtyre personave që janë ekselentë. Për këtë kurs kemi përgatitur një program të veçantë që është në

përputhje me ligjin “ Për arsimin e lartë”, i cili do të jetë 6 muaj intensiv. Mendojmë se në muajin shtator do ta kemi përfunduar dhe këta 150 persona do të jenë në dispozicion të policisë.

Programi është kryesisht për hetimin policor dhe tendenca kryesore jona është të përgatisim oficerë hetues të policisë, por ata do të mësojnë edhe disa elemente bazë, që janë të domosdoshme për ta. Meqenëse vijnë për herë të parë në polici, duhet të njohin mirë armët që kanë në përdorim apo teknikat e arrestimit e të tjera.

Për sa i përket programit të vitit 2019, si praktikë pune, por edhe si kërkesë ligjore ne bëjmë një matricë, programin e kemi të miratuar nga ministria. Por për sa u përket trajnimeve të vazhduara dhe specializimeve bëjmë një matricë programi vjetor për akademinë dhe për Policinë e Shtetit, të cilën mund t’jua vë në dispozicion. Është një praktikë që ne ndjekim çdo vit. Në këtë material janë të gjitha të dhënat se kur do të bëhet një orë mësimore gjatë gjithë vitit 2019, ku do të bëhet, nga kush dhe çfarë mjedesh mësimore do të ketë. Ky është programi vjetor. Ju mund të keni një kopje të këtij programi. Kryesisht janë ato që thashë dhe ne do t’i materializojmë këtë vit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Memaj, për prezantimin nga ana juaj!

Ju përveç rektor i Akademisë së Sigurisë jeni edhe një profesionist i Policisë së Shtetit, kam parasysh se ju keni ardhur në drejtimin e Akademisë pas një karriere të gjatë në Policinë e Shtetit, jo vetëm të gjatë, por edhe të larmishme. Më vjen mirë që ju u përqendruat në gjërat kryesore që kanë të bëjnë me Akademinë e Sigurisë duke ju dhënë mundësinë kolegëve deputetë të bëjnë pyetje dhe të marrin më shumë të dhëna, informacion për veprimtarinë apo edhe misionin e kësaj akademie.

Shkëputja 10-vjeçare që ndodhi nga Akademia e Policisë, sot kemi Akademinë e Sigurisë pati pasojat e saj në të gjithë trupën e Policisë së Shtetit. Është ajo që ju referuam dhe ne që më herët e kemi ndarë në këtë komision me ministrin e Brendshëm. Sot Policisë së Shtetit i mungon një numër i konsiderueshëm oficerësh të gradës “nënkomisar”, që është një gradë, e cila përfaqëson një nivel të domosdoshëm në trupën e Policisë së Shtetit. Fakti që është hapur portali më 1 shkurt, aplikimet duken se janë në një numër relativisht të lartë, nuk mund të themi se është një numër i ulët kur aplikojnë 400 vetë për 150 vende, por do të thotë të jemi besimplotë dhe të kemi një shpresë të mirë që futja e këtyre personave dhe përgatitja e tyre brenda një periudhe 6- mujore do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve brenda Policisë së Shtetit dhe natyrisht në të gjithë punës e saj.

Pa dashur të zgjatem në fjalën time, do të doja t'jua kaloja fjalën kolegëve, nëse kanë pyetje. Pasi të kemi ezauruar pyetjet do t'ju ftoj të bëjmë diskutime. Pra, të përpiqemi t'i mbajmë të ndara.

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia- Faleminderit, zonja kryetare!

Është e vërtetë ajo që thatë për drejtorin e Akademisë së Sigurisë, që vjen me një *background* të admirueshëm, nga grada më e lartë, grada e gjeneralit.

Zoti drejtor, ju falënderoj edhe për ekspozenë që paraqitët në komision!

Unë kam 2 pyetje. Pyetja e parë, ju jeni në këtë detyrë, në rikthimin e Akademisë së Rendit, pasi veprimtaria e saj ishte ndërprerë prej shumë vitesh, a keni përafërsisht ndonjë numër se sa ka qenë ai i aplikantëve që kanë aplikuar në Akademi gjatë kësaj periudhe që kur është rihapur akademia?

Pyetja e dytë, sa prej tyre janë ripozionuar në detyra që kanë rimarrë detyra të reja? Për këtë mund të na ndihmojë edhe drejtori i Personelit.

Pyetja e tretë, ne kemi qenë këtu dhe kemi diskutuar për disa nga problemet që kanë pasur disa nga punonjësit e policisë me rikthimin e zotit Lleshaj në detyrën e ministrit të Brendshëm, ku është paragjykuar se do të rikthehen më tepër persona nga Forcat e Armatosura. Në fakt, ju e përmendët janë rreth 400 vetë që kanë aplikuar: a janë këta nga Forcat e Armatosura, janë nga fusha të ndryshme të universiteteve apo nga sektorë të tjerë?

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Po, zoti Memaj.

Bilbil Memaj – Do të përgjigjem, jo për shifrën se sa kanë aplikuar, sepse e kam të vështirë. Unë kam 4 vjet e gjysmë drejtor i Akademisë së Sigurisë, por do t'ju them një gjë, për sa i përket nivelit të parë për oficer të rolit bazë, për 400 veta që donim të merrnim, kemi pasur rreth 5500 konkurrentë.

Grada “inspektor” bëhet me konkurrim. Për sa i përket gradës tjetër “Nënkomisar” ka qenë raporti 1 me 12, afërsisht kanë konkurruar 12 vetë për një gradë. Këta janë dhe numri më i madh që ka policia, pasi inspektorët janë ata që përbëjnë policinë, janë gati 7 mijë e ca punonjës policie me këtë gradë dhe niveli ka qenë shumë i mirë. Ndoshta e keni ndjerë apo e ka ndjerë çdo qytetar 3 breza që kemi futur punonjës policie të rolit bazë kanë qenë me performancë të mirë edhe nga pikëpamja fizike, por sidomos nga sjellja, etika. Ne jemi munduar të dalin me nivel të mirë nga akademia. Ka ndikuar edhe një gjë tjetër pozitive, gati 40% e inspektorëve që na vijnë për t'u bërë oficerë policie të rolit bazë janë

me arsim të lartë. Kjo kam përshtypjen se është pozitive për sa i përket nivelit, komunikimit e të tjera.

Për sa i përket pyetjes së dytë, do të përgjigjet drejtori, zoti Rica. Në lidhje me pyetjen: me ndryshimin e ligjit, a ka ushtarakë që kanë aplikuar, do të përgjigjesha, jo, sepse ne kemi kërkuar profil ekonomik, shkenca kompjuterike dhe jurisprudencë. Ndoshta ka ndonjë ushtarak që është edhe jurist dhe i plotëson kriteret, nuk e di, por fjala është për këto 3 profile dhe jo ushtarakë, deri tani.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Zoti Rica, mund të vijoni përgjigjen.

Nikollë Rica - Faleminderit, zonja kryetare!

Nisur nga fakti që shkolla bazë ose kolegji policor për 4 vjet ka funksionuar, kemi filluar me 350-400 dhe vitin e fundit që po flasim kemi rreth 200 persona që kanë aplikuar. Mund t'ju raportoj se në datën 3 shkurt kanë filluar edhe 200 punonjës të policisë së patrullës së përgjithshme. Referuar dispozitës së nenit 55 të ligjit "Për Policinë e Shtetit" ku parashikohet një afat për të kaluar nga grada në gradë, çdo vit, për 3 vjetët e fundit kanë aplikuar rreth 100 punonjës policie dhe kanë marrë gradën e "Nënkomisarit". Pra, kur mbarojnë 3 vjet akademike, tani kemi një produkt. Ku kanë shkuar këta? Kanë shkuar në rolin e nënkomisarit, sepse ishin inspektorë. Është rol specialisti, ende për shkak të viteve të punës, vjetërsisë nuk kanë arritur të kalojnë në role menaxheriale. Në vitet që vijnë do t'u krijohet mundësia për të kaluar edhe në role menaxheriale, komisarë edhe më lart.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj, është e qartë dhe për faktin se Akademia e Sigurisë është hapur në vitin 2015 dhe koha trevjeçare përkon me brezin për të cilin ju po flisni.

Fjalën e ka zoti Gjunkshi.

Xhemal Gjunkshi - Përhëndetje të gjithëve!

Unë do të shtroj disa pyetje.

Së pari, historikisht problemet e sigurisë janë trajtuar nga Akademia e Forcave të Armatosura në institucionin e arsimit të lartë, tashmë të akredituara dhe sipas kriterëve të reja realizuar që pas viteve '70-të, dhënien e gradave dhe të titujve shkencorë, ose siç quhet dhe njihet programi i studimeve të nivelit të lartë, niveli i tretë, doktoraturat. Kjo është një konkurrencë e pandershme që i bëhet Akademisë së Mbrojtjes, ku ekspertiza e saj ishte pa dyshim shumë më e mirë dhe me një përvojë rreth 50 -vjeçare. Përse merret kjo përgjegjësi nga Akademia e Sigurisë kur historikisht ka qenë Akademia e Mbrojtjes? E ngre këtë pyetje

për të dyja këto institucione që janë shtetërore dhe kanë ngjashmëri për fushën që flasim. Ne duhet të kemi sinergji dhe jo rivalitet.

Në akademinë tuaj ju bëni kurse të ndryshme: sa kurse me program, kurrikula janë në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe sa jo, duke pasur parasysh se ju si institucion i arsimit të lartë, i zhvilloni të tria programet e studimit?

Në vijim të pyetjes së mësipërme dua të di, sa programe studimi keni të akredituara nga institucionet përkatëse përgjegjëse?

Bazuar në nenin 6 të ligjit “Për disa ndryshime të ligjit nr.108/2014 “ Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar” thuhet : “Për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura, të cilët plotësojnë kriteret e pikës 2 të nenit 38 të këtij ligji”. Në këtë kontekst pyetja që shtrohet është: a mundet që ju për nevojat e Policisë së Shtetit të bëni një planifikim dhe rekrutim të personelit që në fillësë, në shkollat, akademitë ushtarake për t’u përgatitur në specialitete si armatim, xhenjo, kimi për nevoja policore e të tjerë?

A keni kapacitete të besueshme për të bërë testime korrekte dhe të pakontestueshme siç ishte rasti i fundit me Policinë e Burgjeve?

Pyetja e fundit: a keni ju stafin e mjaftueshëm akademik sipas standardeve që të bëjë mbulimin për çfarëdolloj niveli? Cili është ky nivel?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Nuk e di, zoti Memaj, nëse arritët t’i fiksonit të gjitha pyetjet? Sidoqoftë, le t’i shikojmë një nga një.

Bilbil Memaj – Faleminderit, zoti deputet!

Pyetjet janë të një profesionisti dhe unë do të doja që të përgjigjem edhe si një ushtarak. Unë jam një person, që vij vetë nga ushtria, por në një kohë tjetër. Unë e di shumë mirë se çfarë do të thotë të kesh mbaruar apo të mbarosh Akademinë e Mbrojtjes dhe të vish të punosh në policisë, por sipas mendimit tim asnjëherë nuk është marrë dhe nuk mund të merret atributi që ka Akademia e Mbrojtjes për arsye të ndryshme, por kryesorja është që ne kemi objekte pune të ndryshme dhe nuk ka lidhje. Akademia e Sigurisë asnjëherë nuk do të nxjerrë oficerë, të cilët do të merren me mbrojtjen kombëtare, pasi nuk mund ta ketë një atribut të tillë, nuk mund t’i ketë as kapacitetet për të bërë një punë të tillë, por herë pas here në historinë e policisë kanë ardhur oficerë, të cilët kanë mbaruar Akademinë Ushtarake për të plotësuar disa nevoja dhe ky ka qenë vlerësim. Mendimi im është ky: për sa u përket

specialiteteve, policia nuk ka prodhuar asnjëherë, historikisht, as ekspertë xhenierë, as ekspertë të kimisë, as ekspertë të ndërlidhjes, as punonjës që merren me logjistikën, me prapavijën. Unë e di se këtu ka shumë kolegë që e dinë këtë punë, por të gjitha këta ekspert i ka marrë nga Akademia e Mbrojtjes. I ka rekrutuar që në fillim, duke i çuar në shkollë, dhe kur kanë mbaruar, kanë qenë kontingjent i Ministrisë së Brendshme, siç quhej në atë kohë.

E njëjta gjë po bëhet tani, por duke folur për specialitete të veçanta, sipas mendimit tim. Këto specialitete të veçanta po kështu do të vijnë. Ka afërsi të një strukture ose të dy strukturave që ka Policia e Shtetit, të cilat mund të vijnë nga forcat e ushtrisë, siç janë forcat speciale apo ndërhyrja e shpejtë, të cilat jo vijnë direkt e futen aty, por të specializohen për këtë punë. Për mendimin tim, ne mund të përdorim resurse të tilla. Besoj se ju e keni pasur parasysh këtë, kur e keni ndryshuar ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Kaq për pyetjen e parë.

Për pyetjen e dytë: “a janë të akredituara programet që ndjek Akademia e Sigurisë?”, përgjigja është: po, Akademia e Sigurisë, programet që zbaton, baçelor dhe master, janë të akredituara. Nuk është i akredituar institucioni, pasi është në proces. programet janë të akredituara, sepse ne, para se të hapim programin jemi të detyruar ta miratojmë në Ministrinë e Arsimit. Sistemi i akademisë është sistemi i Bolonjës. Pra, ne jemi tre plus dy, në sistemin e Bolonjës. Akademia është në proces akreditimi. Akreditimin nuk e ka ende si institucion, por si program po. Janë miratuar edhe diplomat: diplomat baçelor, diplomat master profesional për sigurinë, diplomat master profesional për hetim krimi.

Të gjitha këto programe janë të miratuara. Jemi akoma në proces për miratimin e programeve të tjera, qoftë edhe specializimeve. Po akreditojmë edhe programet e trajnimeve.

Pra, diplomat që nxjerr Akademia e Sigurisë regjistrohen, çdo student matriculohet, që në momentin e regjistrimit në Ministrinë e Arsimit. Nuk i bëjmë ne, regjistrohen atje, dhe kjo tregon se jemi në një rrjet.

“A i keni të gjitha mundësitë për të bërë testime korrekte?”

Në këtë rast duhet të shpjegoj diçka: në Akademinë e Sigurisë ndiqet një sistem, i cili është pothuajse i pakontestueshëm nga pikëpamja e testeve, sepse ne kemi hequr komisionet, dhe në momentin që bëjmë komisione për intervista, e kemi një model, me të cilin është shumë e vështirë të abuzohet.

Nuk është se në lidhje me këtë çështje kemi gjetur fundin, por megjithatë, provimet që ne bëjmë janë provime me skaner, dhe nuk ka komision. Ky është një sistem i futur që në vitin 2006-2007 në akademi, nuk është se e kemi bërë ne. Ne vazhdojmë ta zbatojmë. Është

sistem amerikan. Nuk ka asnjë mundësi nga pikëpamja e nivelit teorik, që të abuzohet në testet e akademisë.

Edhe në rastin e policisë së Burgjeve, meqenëse për herë të parë testoheshin tek ne, nuk ka pasur abuzime për sa i përket akademisë, sepse nuk mund të ketë. Ajo është një pajisje, e cila lë gjurmë sa herë që ti regjistron ose futesh në të.

Nuk dua të them se jemi të përkryer dhe tek ne nuk ka subjektivizëm, sepse subjektivizëm ka gjithandej, gjë që duhet ta pranojmë, por ne po mundohemi e po luftojmë që t'i japim hakun çdo studenti, apo kursanti që vjen për gradë.

Në lidhje me pyetjen tjetër: po, akademia ka pedagogë shumë të mirë, me eksperiencë. Nga katër departamentet e Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, njëri departament ka tetë pedagogë, ndërsa të tjerët nga shtatë pedagogë. Pjesa më e madhe e tyre, Departamenti i Formimit Juridik dhe i Përgjithshëm, ne i kemi pedagogët civilë, që kanë punuar nëpër fakultete e më pas kanë ardhur te ne, të cilët kanë tituj e grada shkencore. Të tjerët janë me eksperiencë, me grada të larta policore. Pjesa më e mirë e tyre janë shumë të aftë. Natyrisht, ne tani po bëjmë një binjakëzim, që shpresojmë ta finalizojmë, me një akademi të Bashkimit Europian, si dhe do të mundohemi që ose t'i çojmë pedagogët tanë për kualifikim atje, ose t'i sjellim ata këtu.

Ky është një proces që nuk ka fund, dhe ne po përpiqemi ta ngremë nivelin, por pedagogu është gjithçka. Unë jam dakord me ju që, nëse nuk mungojnë kapacitete pedagogësh nuk mund të bësh shkollë. Eksperienca që kemi në Akademi është e tillë, që ka një bazë të mirë mësimdhënëse.

Pra, kjo ishte përbërja e stafit dhe e nivelit të stafit që ne kemi.

Ne kemi bërë një propozim për të plotësuar kriteret e akreditimit, pasi akreditimin duhej ta kishim marrë edhe përpara universiteteve të tjera, sepse i plotësojmë kriteret, por nuk plotësojmë kriterin e numrit të pedagogëve për tituj dhe grada shkencore. Duke qenë akademi e re, ne nuk kemi pasur mundësi të kemi njerëz me tituj shkencorë, por kjo do të kalojë, pasi me ligjin “Për arsimin e lartë”, pedagogët që kanë grada të larta policore mund t'i konvertojmë dhe të mos i përjashtojmë nga akreditimi. Ne jemi akademi specifike, e veçantë, nuk mund të jemi njësoj si universitetet e tjera. Megjithatë, ky është një proces që duhet parë si do të ecë. Jam i bindur se brenda këtij viti do ta akreditojmë akademinë, e pastaj do të funksionojë normalisht.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjunkshi dhe zoti Memaj, për përgjigjet!

Fjalën e ka zonja Dhima. Pastaj zoti Salianji!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Dihet se Akademia e Sigurisë është një institucion publik i arsimit të lartë, që synon arsimimin e punonjësve të policisë, por gjithashtu edhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese.

Nga datë 1 shkurt deri më 15 shkurt kanë filluar aplikimet për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit. Në fjalën tuaj, ju thatë se janë 400 aplikime për 150 vende vakante. Pyetja ime e parë: si është raporti i këtyre aplikimeve? Sa janë femra e sa janë meshkuj?

Pyetja e dytë: kursi që do të bëhet pranë kësaj akademie dhe personat që do të përzgjidhen deri në fund të procesit, do të jetë me pagesë apo jo?

Pyetja tjetër: ndryshimet e propozuara në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, i cili është miratuar në dhjetor, parashikon plotësim të boshllëqeve ekzistuese në nivelin bazë të piramidës së gradave të Policisë së Shtetit, për gradën nënkomisar. E dyta, pasurim të nivelit të ekspertizës së Policisë së Shtetit me specialistë, të cilët deri tani kanë munguar, plotësim të cilin do ta bëjë akademia juaj. A keni ju burime njerëzore të mjaftueshme për kryerjen e kurseve për trajnimin në fushën e krimit ekonomik dhe atij financiar, pastrimit të parave, krimit kibernetik e të tjera si këto?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Memaj.

Bilbil Memaj – Faleminderit për pyetjet!

Më vjen keq t'ju them se nuk jam në gjendje t'ju bëj me dije sa janë femra e sa janë meshkuj, sepse nuk e kemi ende rezultatin përfundimtar. Ne ndjekim se sa është numri i atyre që aplikojnë, por jo të dhënat, sepse kështu është i ndërtuar portali, që kur mbyllet, fillojnë të zbardhen. Megjithatë, mund t'ju them se si është raporti në akademi midis vajzave dhe djemve, në shkollën bazë apo në fakultet. Deri tani kemi 33 %, për nënkomisar, dhe 21 % i kemi të rritur bazë, sivjet. Sot që po flasim, ne kemi 704 studentë në të dyja njësitë, në Akademinë e Sigurisë.

Le të shpresojmë të ketë më shumë vajza.

Si do të ndiqet kursi?

Kursi do të jetë 6 muaj intensiv dhe asnjë nga ata që fitojnë të drejtën për ta ndjekur këtë kurs, nuk kanë detyrime. Ata janë kursantë, dhe në bazë të ligjeve që ka shteti, ata trajtohen në Akademinë e Sigurisë me fjetje dhe ushqim, si dhe vishen, pasi duhet të jenë me uniformën e stërvitjes. Plus, marrin edhe 10 mijë lekë të reja çdo muaj. Kjo është. Nuk kanë detyrime financiare.

Për sa i përket pyetjes së fundit, e cila po ashtu është shumë interesante: “A i ka akademia kapacitete për të bërë të mundur trajnime për krimin ekonomik, krimet kompjuterike e të tjera?

Nuk i ka të gjitha. Akademia e Sigurisë bashkëpunon me Universitetin Publik të Tiranës për të marrë pedagogë. Kemi po ashtu një marrëveshje edhe me Fakultetin Ekonomik. Shumë profesorë të Fakultetit Ekonomik vijnë e japin mësim te ne, pasi ne nuk mund t’i plotësojmë këto nevoja.

Për sa u përket krimeve kompjuterike, deri tani e kemi mbuluar nga misioni PAMECA dhe ICITAP. Nuk i kemi bërë vetë, megjithëse kemi dy pedagogë, të cilët po i lëmë të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme sa herë që bëjnë trajnime me këta partnerë.

Natyrisht, në këtë drejtim kemi shumë për të bërë, por mbase këta që po vijnë tani, do të jenë pedagogë dhe dikush prej tyre mund të shkëlqejë, sepse për këtë arsye po i marrim nga të ekselencës e me fakultet të krimeve kompjuterike.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Salianji.

Ervin Salianji – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, sot kemi seancë dëgjimore me drejtuesin e Akademisë së Sigurisë, dhe pa diskutim që është e lartë pritshmëria e publikut për këtë akademi, ku hyjnë, trajnohen, dalin punonjësit e nesërm Policisë së Shtetit. Sidomos në kushtet kur në Shqipërinë e sotme nuk kuptohet nëse polici është polic që përfaqëson shtetin dhe interesin e publikut, apo si në shumë raste, tashmë të faktuara me vendime gjykatash, polici ka përfaqësuar interesat e bandave dhe të krimit. Madje edhe drejtues të lartë të policisë, si Çela apo Kohila dhe Bode në Vlorë.

Sot jemi në kushtet kur, pa diskutim, pritshmëria ndaj Akademisë së Sigurisë është shumë e madhe, jemi në kushtet kur kapen tonelata me drogë. Vetëm sot, përballë brigjeve tona, në Itali, janë arrestuar 21 shqiptarë, ndërsa mijëra të tjerë janë sot nëpër burgjet e Europës, për shkak të një politike të gabuar, që nuk e di nëse në Akademinë tuaj të Sigurisë e kanë pësuar apo juanë trajnuar që, kush shkel ligjin përfundon në burg, dhe jo kush i shërben shefit në mënyrë të verbër promovohet.

Për shkak të kësaj politike, sot mijëra familje i kanë fëmijët e tyre nëpër burgje, në shumë raste pa faj, edhe në Shqipëri.

Doja t'ju pyesja drejtpërdrejt: a ka dalë përgjegjësi në akademinë tuaj, a keni pasur ndonjë konkluzion në lidhje me akuzat për nxjerrjen e testeve të akademisë, që shumë studentë apo aplikantë kanë bërë në publik, se konkurset për t'u bërë pjesë e Akademisë së Sigurisë, në shumicën e rasteve apo në shumë prej rasteve përdoren më tepër për të futur militantë partiakë, apo si shpërblim për angazhimin në zgjedhje të rinjve apo të rejave, të cilët e kanë ndihmuar konkretisht Partinë Socialiste, se sa për të përzgjedhur më të atit dhe ata që duhet t'i shërbejnë më mirë publikut, sidomos kur është fjala për një institucion, i cili duhet të jetë, e në fakt është, fytyra e shtetit, meqenëse e përfaqëson çdo ditë dhe uniforma e tyre përballët çdo ditë me qytetarët, të cilët u kërkojnë shërbime.

A ka aty tek ju, te Akademia e Sigurisë, edhe një test psikologjik, për t'u përballur me situata të ndryshme? A është krim për ju e për akademinë, kur vijnë denoncues, të cilët denoncojnë përdhunime nga ana e Policisë së Shtetit, siç ishte rasti i një militanti partiak të Partisë Socialiste, në Malësinë e Madhe, për të cilin disponoj fakte, nuk është vendi dhe s'mendoj se publikut intereson. Unë disponoj edhe video konkrete, që janë denoncuar për këtë personazh, që përfaqëson Policinë e Shtetit, por që është një neveri për të gjithë shoqërinë shqiptare, se si kanë shkuar në komisariatet e policisë të Malësisë së Madhe dhe në Shkodër për të treguar traumat dhe dhunën që ushtron një zyrtar i shtetit, por nuk ka asnjë reagim. Madje ka pasur tallje.

A ka një test? A i mësoni ju në mënyra të ndryshme në akademi?

Doja të dija nëse, por mund të përgjigjeni, mund të mos përgjigjeni, por si drejtues i Akademisë së Sigurisë, a keni një qëndrim në lidhje me gjendjen ku ndodhet Policia e Shtetit sot, si dhe situatën e kriminalitetit e të sigurisë publike? Sepse, edhe për studentët aty, por sidomos për ata që duan të aplikojnë dhe duan ta shohin policinë si një vend ku i shërbehet publikut, do të ishte një mesazh, i cili mbase do të kishte njëfarë jehone ndryshe prej atyre që dëgjojmë përditë nga Policia e Shtetit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Përpara se t'ia jap fjalën zotit Memaj për përgjigjet, desha të vë në vëmendjen e kolegëve tri gjëra.

Së pari, zoti Memaj është këtu si rektor i Akademisë së Sigurisë. Akademia e Sigurisë është institucion i arsimit të lartë publiq, dhe si i tillë gëzon liri akademike.

Së dyti, nuk kemi ardhur për rezultatet e kriminalitetit. Do të kemi drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për të diskutuar për raportin, meqenëse tani ka mbaruar analiza në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Aty mund të diskutojmë në lidhje

me shifrat e kriminalitetit. Sa për informacion, janë 34 mijë e 468 vepra penale vetëm për vitin që shkoi, ndërsa zbulueshmëria është 86, 6 %, gjë që do të thotë se puna e mirë e policisë reflektohet në këto shifra.

Megjithatë, unë nuk dua t'i paragjykoj pyetjet tuaja. Për çështjet që ju shtruat si pyetje lidhur me trafikimin lëndëve narkotike, nesër në orën 12 do të ketë një prezantim të Policisë së Shtetit, ku ne jemi të ftuar si Komision i Sigurisë. Natyrisht, aty mund të adresojmë edhe pyetjet tona.

Po ia kaloj fjalën zotit Memaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – Për procedurë.

Ermonela Felaj – Po.

Flamur Noka – Zonja kryetare, në rast se kërkojmë që çdo mbledhje e këtij komisioni të ketë mbarëvajtje konform procedurave dhe Rregullores së Kuvendit, do të duhet të mos i ndërhyri duke u kthyer përgjigje pyetjeve që bëjnë deputetët, sepse deputetët adresojnë pyetje ndaj panelit të të ftuarve, jo ndaj jush. Ju nuk jeni këtu për t'u kthyer përgjigje deputetëve e as si suflere. Prandaj, të lutem! Më avash edhe me ato shifrat e zbulueshmërisë së krimit, sepse deri tani kemi parë vetëm ata që vetëdorëzohen. Të tjerët ju i zbuloni veç në ëndërr, se ndryshe jo. Të paktën mundohu ta drejtosh dhe ta menaxhosh situatën konform Rregullores. Mos u kthe përgjigje deputetëve, mos u ndërhyj deputetëve! Deputetët nuk të bëjnë asnjë pyetje ty, zonjë, nuk të drejtohen ty, por panelit të të ftuarve!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Memaj, mund të vijoni me përgjigje tuaja!

Bilbil Memaj – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë: a keni bërë ndonjë testim se si është gjendja? Po, gjendja s'ka qenë shumë e mirë, prandaj po ju them se ishte shumë e domosdoshme që ne të hapnim këto kurrikula, të hapnim këto kurse.

Nuk dua të paragjykoj vendimin që është marrë dikur për mbylljen e akademisë, po për mendimin tim kjo ka sjellë pasoja. Pavarësisht nga kjo, mendoj se gjendja po shëndoshet. A jemi aty ku duhet? Natyrisht jo. kemi shumë punë për të bërë. Duhet patjetër që policia ta ndjekë këtë karrierë, si dhe policitë e tjera të Bashkimit Europian.

Unë ju thashë një shifër, që ne bëjmë afërsisht 42 shkollime e trajnime. Të tjerët e kanë dyfish. Ne nuk mund ta pretendojmë këtë sot, pasi kemi shumë nevoja të tjera imediate,

të cilat duhet t'i plotësojmë. Këto nevoja duhen plotësuar tashmë, sepse i kërkon situata e strukturave të policisë, dhe gradualisht duhet ngritur niveli.

Një pyetje tjetër është: a bëni teste psikologjike, sepse ka probleme me punonjësit e policisë?

Bilbil Memaj – I nderuar zoti deputet, ju e dini se psikologjia është shkencë e vështirë. Natyrisht, ne bëjmë teste psikologjike, sepse ki është një nga testet për t'u futur në polici. Ashtu sikundër psikologjia merret me gjendjet dhe veçoritë psikike të njeriut, ka shumë vështirësi nga pikëpamja subjektive për të vlerësuar e për të matur saktë të dhënat e çdo personi e të çdo individi. Po ju them se i kemi ndarë dhe grupuar edhe punonjësit e policisë, kur mbarojnë, se çfarë karakteri u përkasin dhe çfarë personaliteti kanë. më aps, në terren është shumë e vështirë t'i ndash e të shikosh se si bashkëpunojnë me të tjerët. Kjo duhet të jetë punë e vazhdueshme, nuk duhet të jetë vetëm në akademi, por edhe si trajnim i vazhduar.

Për sa i përket ligjit, nëse i mëson akademia, natyrisht që po: “a”-ja në akademi është ligji, dhe “a”-ja janë të drejtat e njeriut. Nuk ka asnjë kurrikulë në akademi, që të mos përmenden e të mos trajtohen këto gjëra.

Unë mendoj se, meqenëse ju jeni ligjvënës dhe duhet t'i shikoni se si zbatohen edhe në terren gjërat, në bazë të ligjeve që ju nxirrni, por është mirë t'i shikoni edhe një akademia e si bëhen, qoftë edhe si bëhet një test, sepse padrejtësisht iu hodh baltë akademisë në këtë drejtim, në lidhje me testin. Nuk është bërë asnjëherë vjedhje teze në akademi, sepse s'ka si të bëhet. Në fakt, asnjëri nuk e kupton, nëse nuk e shikon aty, konkretisht, se si punohet. Është shumë e vështirë ta pranosh mënyrën se si zhvillohet kjo tezë.

Për sa i përket nivelit në përgjithësi, unë e thashë edhe më lart se ky është viti i katërt që po funksionon akademia, dhe natyrisht, nuk mund të pretendojmë që të kemi një feedback për ata që dolën, sepse ata duhet të punojnë një vit apo dy vjet, që të themi se si duhet bërë përmirësimi i programit akademik. Këtë e kemi të vështirë ta bëjmë tani, pa i provuar gjërat në praktikë.

Nuk e di nëse iu përgjigja të gjitha pyetjeve apo jo.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Memaj!

Do ta vazhdojmë radhën e pyetjeve me pyetjet e zonjës Gjebrea. Më pas zoti Murrizi.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, dëshiroj të falënderoj drejtuesit këtu: zotin Memaj dhe zotin Rica, sepse vërtet kanë ndihmuar që Akademia e Sigurisë të ketë një fytyrë tjetër, për sa i përket procesit të vet drejt modernizimit e për të realizuar shkollimin bazë policor, kaq të nevojshëm, të gjitha ciklet e studimit të sigurisë, përfshirë këtu edhe kualifikimin policor.

Dëshiroj ta theksoj edhe një herë faktin se Akademia e Policisë është rihapur në vitin 2015, dhe kanë qenë dhjetë vjet mungesë, nuk janë pak, të cilat patjetër kanë sjellë vështirësi shumë të mëdha në kualifikimin sipas gradave, sidomos në mungesën e theksuar të gradës nënkomisar, që u theksua këtu e të tjera. Kështu që, falë përkushtimit të drejtuesve kryesorë dhe të gjithë punonjësve që punojnë aty, është arritur që sot akademia të ketë një fytyrë tjetër, dhe pa diskutim që meriton shumë më shumë për sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me vendin që i takon si institucion i lartë arsimor.

Prandaj, ne duhet ta mbështesim, qoftë në procesin e akreditimit, qoftë edhe për më shumë, në ofrimin e gradave master, pse jo dhe të doktoraturës. Kam parë se disa universitete të tjera ofrojnë nivel master në fushën e sigurisë, por kush më mirë se Akademia e Sigurisë mund ta ofrojë këtë? Kësisoj, mendoj se duhet ta mbështesim. Në qoftë se drejtori kërkon një mbështetje nga ana jonë, si Komision i Sigurisë, besoj se ne duhet t'ia japim, nëse na e bën me dije këtu.

Nga ana tjetër dëshiroj ta ritheksoj faktin se pasurimi i nivelit së ekspertizës së Policisë së Shtetit me specialitete të munguara, për të cilat Akademia e Sigurisë ka vuajtur, e kemi të zgjidhur me miratimin fundit të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Unë e bëra një pyetje, që ka të bëjë me nivelin e masterit. Pikërisht ky boshllëk, i cili u miratua edhe me ligjin e fundit “Për Policinë e Shtetit”, mendoj se do ta rikuperojë gjithë atë nevojë që akademia ka në procesin e ndihmës në luftën kundër krimit kibernetik, krimit ekonomik e më gjerë. Besoj se edhe drejtuesit e Akademisë së Sigurisë e kanë në vëmendje këtë, që lufta ndaj krimit sofistikohet, prandaj kërkohet edhe një ekspertizë në nivel të lartë, pse jo duke inkurajuar edhe marrjen e ekspertëve të huaj për cikle të caktuara studimi.

Pyetja ime e dytë zotin Memaj, ka të bëjë pikërisht me këtë. Duke i riformuluar edhe një herë pyetjet: a keni nevojë për mbështetje, për sa i përket ofrimin të nivelit master dhe doktoraturë, në Akademinë e Sigurisë; a është e mundur kjo brenda hapësirës që ju keni si institucion i lartë arsimor? Pyetja e dytë: a keni nevojë për mbështetje për ekspertiza të veçanta, në ofrimin e kurseve nga lektorë të huaj? Përsëri, edhe këtu do të keni mbështetjen tonë.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit për pyetjet, zonja Gjebrea!

Po, zoti Memaj!

Bilbil Memaj – Faleminderit! Faleminderit edhe për fjalët e mira që thatë në lidhje me Akademinë e Sigurisë!

Më duhet t'ju them se në vizionin që ka akademia për dhjetë vjetët e ardhshme, ne e kemi këtë si pikësynim, por nuk mund të ecim menjëherë për të hapur master shkencor, pa përgatitur dhe pa parë nivelin e bachelorit e të masterave profesionale. Pra, kjo do të vijë hap pas hapi.

Për sa u përket doktoraturave në polici, ne kemi bërë një projekt. këto do t'i bëjmë së bashku me Universitetin Publik të Tiranës, në bazë të marrëveshjes që kemi nënshkruar. Në vitet e ardhshme do të jetë shumë i vështirë sigurimi i kapaciteteve të profesoratit të akademisë, për të mundësuar dhënien e gradës shkencore doktor shkencash, megjithëse janë të nevojshme. Kjo është e mundur në bazë të ligjit “Për arsimin e lartë”, duke kooperuar me profesoratin e Universitetit Publik të Tiranës, për arsye se nga grada komisar e deri në gradën drejtues madhor, që është drejtori i Përgjithshëm, ne futemi në nivelet e menaxhimit. Do të ishte shumë interesante, që këto diploma t'i kishim së bashku me universitetin, unë them me Universitetin Publik të Tiranës, por ne po kërkojmë të binjakëzohemi edhe me akademi të ngjashme me tonën, në Bashkimin Europian. Tashmë kemi një projekt me një akademi të Gjermanisë, e cila do të jetë shumë frytdhënëse edhe për gradat shkencore.

Çfarë kemi nevojë? Natyrisht, ne kemi nevojë që në Akademinë e Sigurisë të vijnë ekspertë nga jashtë shtetit, të vijnë lektorë mësimdhënës, por edhe të na ndihmojnë për akademinë. Ne jemi ende në fazën e formatimit, kështu që është nder për ne, që të na asistojnë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Murrizi. Më pas zoti Shameti.

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti drejtor, do të doja të dija nëse provimi i gradave përfshihet në tagrin e akademisë apo është një komision ekstra, jashtë akademisë, i gradave policore.

E dyta: sa nga stafi akademik i Akademisë së Sigurisë janë ish-oficerë të Sigurimit të Shtetit apo me shkollën e ish-Sigurimit të Shtetit?

Një pyetje për zotin Rica, meqë është drejtori i personelit të Policisë së Shtetit, por ndoshta pyetja është edhe për ju, zoti drejtor: a ka kapërcim ligjor në dhënien e gradave, për

katër vjet drejtues i parë, nga drejtori i Policisë së Përgjithshme, që është zot Ardi Velu, kur ligji “Për Policinë e Shtetit” përcakton qartë se duhet të jetë dhjetë vjet drejtues dhe 15 vjet brenda radhëve të policisë?

Thatë se sot kemi 700 studentë në akademi. Mbi ç’bazë hapet konkursi për rekrutimin e studentëve? Ka ndonjë analizë nga drejtorja e personelit, se sa personel policor janë pranë pensionit, në trevjeçarin fundit? Nuk ka përgjegjësi akademia për ata që mbarojnë akademinë, dhe nuk ka detyrim që ata të jenë të punësuar brenda policisë. Pra, vetëm nxirrni studentë, dhe nuk është brenda këtij studimi se sa do të lirohen nga policia, rekrutimi i tyre bëhet me fushatë, apo ju jeni të pavarur nga politika që bëjnë ministrat që venë e vijnë në karriget e ministrit të Brendshëm? Ky i fundit, Leshi, ka shpallur një tjetër prioritet, ndoshta do t’ju duhen më shumë rekrutime të reja, fillimisht kur erdhi tha: “Do t’i peshoj me kile ata që kanë bark të madh, nuk do t’i lejoj të punojnë në polici”. A ka një studim nga Akademia, nga 11 mijë policë, sa prej tyre e kapin këtë kriter që ka vendosur Lleshi, se ndoshta do të duhet të hapni shumë vende të reja?

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Mema.

Bilbil Mema – Faleminderit për pyetjet!

Po ju sqaroj për të gjitha një nga një, se ju, zoti deputet, bëtë shumë pyetje brenda pyetjeve: i kujt është atributi i komisionit të gradave, i Akademisë, apo i policisë? Në bazë të Rregullores, që është miratuar me vendim qeverie, Akademia e Sigurisë ndjek të gjitha procedurat për konkursin, shkollimin, gradimin e të gjithë policisë, por jo vetëm, edhe të të gjithë institucionit të sigurisë. Komisionet e gradimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, jo nga Drejtori i Akademisë. Ç’do të thotë procedurë? Tezat, materialet, temat të gjitha përgatiten nga akademia, mënyrën e bërjes së testit e përgatisin pedagogët e akademisë, ose drejtuesit për gradat të vendosur nga Drejtori i Përgjithshëm, fjala vjen, shumë drejtorë të Drejtorisë së Përgjithshme kanë qenë në komisione për gradë. Këto i vendos Drejtori i Përgjithshëm, jo Drejtori i Akademisë. Komisionet e gradimit i miraton Drejtori i Përgjithshëm. Kriteret janë të vendosura në Rregullore dhe janë miratuar me vendim qeverie se si bëhen.

Për sa i përket procedurës se cilët i përgatisin tezat, se ne kemi një bankë të dhënash për pyetjet, që janë 3000 pyetje për një provim, të gjitha këto i përgatit Akademia. Pra, si të thuash, të gjitha i kemi bashkë, ne ndjekim punën akademike, kurse anën administrative e ka Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, i cili në çdo rast miraton me urdhër anëtarët e komisioneve.

Aty mund të jenë anëtarë edhe pedagogë të akademisë, sepse kuptohet, ne jemi vet punonjës policie.

Pyetja tjetër ishte: a ka në Akademi pedagogë që kanë mbaruar shkollën e Sigurimit dhe sa janë? Këtë nuk e kam menduar ndonjëherë dhe nuk i kam parë sa janë. Në qoftë se ju më drejtoheni mua, po ju them që nuk e kam mbaruar shkollën e Sigurimit, megjithëse mund të keni këtë përshtypje...

(Diskutim pa mikrofon)

Ja pse po ju sqaroj, që edhe kur jemi përballë, ju ta dini. Unë nuk kam mbaruar degën e Sigurimit, por kam mbaruar Akademinë Ushtarake, degën “Zbulim”, kam mbaruar Akademinë e Rendit, degën “Polici” dhe pastaj disa shkolla të tjera. Në përgjigje tuajën, shkolla është quajtur Shkolla e Lartë e Ministrisë së Brendshme dhe ka pasur tre degë: dega e “Kufirit”, dega e “Sigurimit” dhe dega e “Policisë”. Mbas vitit 1990, këto nuk kanë ekzistuar më dhe shkolla është unifikuar në kuptimin e programit, se edhe atëherë programi miratohej nga Ministria e Arsimit dhe nga ministri i Brendshëm.

Nuk di të them se cili ka mbaruar atë e këtë degë, se nuk i kam paragjykuar këto gjëra.

(Diskutim pa mikrofon)

Mund të përgjigjet drejtori, unë nuk kam informacion për këtë punë!

Si hapen konkurset, ishte pyetja tjetër, Drejtoria e Burimeve në Polici, por jo vetëm, në Gardën e Republikës dhe në të gjitha institucionet në varësi, në studimin e vitit dhe gjatë tij, nxjerr personelin vakant për shkak të daljes në pension, largimit nga policia e të tjera, dhe e sjell me shkresë kërkesën që u duhen kaq inspektorë, nënkomisarë, komisarë. Ne përgatisim procedurën që ju thashë, drejtori nxjerr urdhrin për komisionet dhe zhvillohen konkurset. Konkursi i parë bëhet me shkrim dhe nuk bëhet me komision. Ndaj ju thashë se aty nuk mund të kopjohet. Ai bëhet me SKANTRON. Do të ishte interesante për ju si komision ta vizitoni akademinë në një rast të tillë për të parë si realizohet një procedurë. Unë kam ftuar edhe gazetarët që të vijnë të shohin si realizohet një procedurë testimi, sa mundësi manipulimi ka dhe ana subjektive, flas për testin teorik. Ju ftoj të vini e ta shihni edhe ju!

Për sa i përket nivelit, unë u përgjigja. Ndoshta drejtor Nikolla mund të ketë diçka për të shtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Më falni një minutë, zoti Murrizi, do t’jua jap fjalën për të bërë pyetjen tuaj!

Të mos i futemi kësaj teme, sepse ligji ndalon ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit të Shtetit të zgjidhen apo rekrutohen në funksione të ndryshme shtetërore, dhe jo ata që kanë bërë këtë shkollë, janë të përjashtuar. Kështu që nuk më duket e udhës ta shtrojmë këtë temë diskutimi për sa kohë kemi këtë qëndrim unanim.

Myslym Murrizi - Ligji nuk ndalon që edhe unë të marr informacion, sa janë ish-sigurimsa, se po më flisni për ligjin.

Drejtor, anulimi i provimit të gradave është përgjegjësi e Akademisë dhe pse ndodhi?

Bilbil Memaj – Është anuluar vetëm një konkurs, ai i gradës për “Komisar”. Gjatë kontrollit që bë në provimin me shkrim u konstatua që disa nga konkurrentët kishin marrë aparatet e telefonit celular me vete. Për këtë drejtorja që merret me kontrollin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me performancën, i ka bërë Drejtorit të Përgjithshëm një raport ku e quan të papranueshëm zhvillimin e testimit në prani të aparateve celulare dhe u gjykua që të anulohet. Kjo ka qenë procedura, dokumentet janë aty. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë urdhëroi anulimin e konkursit dhe konkursin tjetër nuk e bëri në Akademi, por në Ministrinë e Arsimit, po me të njëjtën procedurë.

Kjo çështje është diskutuar gjatë, nuk është se ka dalë teza dhe është shpërndarë, por arsyeja ka qenë se gjatë kontrollit u konstatua se janë përdorur aparate celulare. A u kopjua me to, apo jo, këtë nuk mund ta thotë kush, sepse ne nuk e morëm për bazë rezultatin.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala për zotin Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë dua të falënderoj drejtuesit e Akademisë së Sigurisë për pjesëmarrjen në Komisionin e Sigurisë edhe për gjithë informacionin e dhënë! Në një farë mënyre drejtori ma dogji sugjerimin kur tha se na ftonë për t’i vizituar, sepse desha ta ngrija në komision, që të gjithë, sikurse është ndjekur si praktikë edhe në institucionet e tjera...

(Diskutim pa mikrofon)

Patjetër! Kjo do të thotë se jemi në një gjatësi vale.

Do ta çmoja shumë të vlefshme një vizitë tonën atje, edhe për t’i parë gjërat në vend, edhe për të qenë ne të qartë nga A-ja te Zh-ja për të gjithë veprimtarinë e Akademisë së Sigurisë nga njëra anë, dhe për të shmangur çdo lloj dyshimi dhe ambiguiteti që mund të ketë opinioni në përgjithësi për veprimtarinë e kësaj akademie.

Nga ana tjetër, përpos atyre që drejtuesi i Akademisë së Sigurisë parashtroi këtu, e kam me shumë merak punën e bashkëpunimit me PAMECA-n, ICITAP-in brenda Akademisë, e sidomos marrjen e praktikave dhe përvojave më të mira që në nivelin bazë të kualifikimit atje. Nëse do të na i sqaronit këtë në detaj, do ta vlerësoja shumë.

Faleminderit!

Bilbil Memaj – Faleminderit!

Mirë se të vini në Akademi!

Sa i përket pyetjes se si bashkëpunojmë me misionet ndërkombëtare që janë të vendosura në Policinë e Shtetit dhe në Shqipëri, ne kemi bashkëpunim të ngushtë si me ICITAP-in edhe me PAMECA-n, madje PAMECA ka edhe një zyrë në Akademi, ka një ekspert afatgjatë që është i atashuar aty, i cili bashkëpunon çdo ditë me ne për sa i përket ndjekjes së kurrikulave dhe programeve.

Po kështu, edhe me ICITAP-in kemi bashkëpunim shumë të ngushtë. Ne kemi bërë diçka, në këtë matricë kemi harmonizuar të gjitha mundësitë që kanë jo vetëm këto dy misione, por edhe misionet e tjera për t'i futur këtu. Të gjitha nevojat që kemi, ua kemi paraqitur këtyre misioneve dhe i kemi futur në këtë matricë, sepse vitet e tjera kemi pasur probleme, pasi shumë nga partnerët tanë na ofrojnë trajnime, por mundet të na ofrojnë trajnime të njëjta. Ne kemi bërë një ndarje dhe u kemi thënë të gjithëve se tashmë duam edhe t'i strukturojmë këto trajnime dhe kjo matricë na ka ndihmuar për t'i strukturuar.

Bashkëpunimi ynë është i hapur, i singertë, sidomos në ato fusha që ne e kemi shumë të vështirë të kemi kapacitete për të trajnuar policinë shqiptare, dhe jo vetëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit juve!

Zoti Brahimllari, fjala është për ju.

Endrit Brahimllari – Falënderoj rektorin e Akademisë së Sigurisë!

Në objektivin e çdo ligjvënësi, por edhe anëtari të Komisionit të Sigurisë, Akademia e Sigurisë ka një rëndësi të veçantë dhe të gjithë ne kërkojmë që të ketë nivele shumë të larta për shkak se përgatit oficerë policie, që nesër do t'i shërbejnë vendit dhe do të ruajnë rendin dhe sigurinë publike. Në këtë drejtim besoj se është detyra kryesore e Akademisë së Sigurisë që këta drejtues të ardhshëm të policisë, të cilët do të fillojnë të bëjnë karrierë nga niveli bazë duke u graduar me radhë, si pikë kryesore të tyre të kenë zbatimin e ligjit, duke filluar nga ligji i Policisë së Shtetit, por edhe Kushtetutën e vendit. Po në këtë kuadër, kam disa pyetje: unë personalisht jo se nuk kam besim tek Akademia e Sigurisë, por nuk kam besim te ndikimi

politik që mund të ketë për shkak të ndërhyrjes së Kryeministrit. Është bërë tashmë e famshme thënia e tij publike, në mos gaboj, në fushatën elektorale: “Policia e Shtetit të heqë kapelat dhe të bëjë fushatë për Rilindjen”, duke shkelur rëndë ligjin e Policisë së Shtetit, por edhe Kushtetutën, çka nënkupton qartë që këta oficerë të ardhshëm mund të intimidohen në zbatimin e ligjit.

Në kuadër të kësaj, për të përmirësuar cilësinë e Akademisë së Sigurisë, por edhe për të njohur më nga afër funksionimin e saj, unë kam një pyetje konkrete, meqenëse dy pyetjet e tjera për anulimin e procesit të gradimit morën përgjigje dhe u sqaruam. Ju thatë se ka një njësi kërkimore-shkencore brenda Akademisë. Çfarë parashikon kjo njësi, çfarë fondesh ka dhe sa i realizon objektivat e saj, sepse në logjikën time është një njësi, e cila ka të bëjë kryesisht me kriminalitetin, ndoshta me krimin kibernetik e të tjera me radhë?

Kam edhe një pyetje tjetër, që më shumë është një formë shqetësimi, Akademia e Policisë është e përfshirë në emërimet e Policisë së Burgjeve? Ta sqarojmë edhe për opinionin publik, por kjo e njësisë kërkimore është e rëndësishme për të kuptuar edhe aftësinë që mund të ketë nesër Akademia e Sigurisë për të përgatitur drejtues apo oficerë të zotë.

Ermonela Felaj – Besoj se pyetjet e zotit Brahimllari janë të qarta, kështu që mund të vijoni me përgjigjet, zoti Mema.

Bilbil Memaj – Faleminderit për pyetjet!

Po e nis me përgjigjen për pyetjen e fundit, me qëllim që të flas më gjatë për pyetjen e parë. Akademia e Sigurisë nuk merret me emërimet, as të Policisë së Burgjeve dhe të asnjë institucioni tjetër. Ne merremi vetëm me trajnim-shkollimin. Na vijnë kontingjentet dhe merremi me ta. Kemi rënë dakord për kurrikulën së bashku me institucionin përfitues dhe e zbatojmë atë. Bëjmë vlerësimet dhe ia nisim zyrtarisht institucionit. Kështu kemi bërë edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, që i takon Ministrisë së Drejtësisë.

Pyetja tjetër, se me çfarë merret kjo njësi e Akademisë, është shumë interesante: kur e ndërtuam Akademinë gjykuam se për sigurinë e brendshme (në qoftë se do t’i mbledhim të gjitha institucionet, janë afërsisht 19 mijë punonjës në Shqipëri), nuk kishte një njësi bazë që të merrej me hulumtimet shkencore dhe problematikën që dalin dhe menduam që të kemi një qelizë me pak veta për të bërë kërkime shkencore në këtë drejtim. Po si punohet aty? Si ka funksionuar? Ne marrim pjesë në analizat përfundimtare të policisë, apo të institucioneve të tjera dhe nxjerrim problematikën e vitit, fjala vjen, kur numri i vrasjeve në familje u rrit, ne bëjmë një studim për të. Kur krimet kompjuterike në vend filluan të rriten, ne bëjmë një konferencë shkencore vetëm për këtë temë, ku ftuam nga të gjitha universitetet dhe akademitë

e Europës, të cilat na u përgjigjën. Lidhur me këto konferenca, kemi edhe materiale të botuara. Që nga momenti i krijimit e deri më tani, kjo njësi ka nxjerrë dy revista, ku nuk botojmë vetëm ne, por edhe të tjerë, civilë, pra, mund të botojnë të gjithë ata që merren me kërkimin shkencor. Me këtë njësi i jemi përgjigjur, si të thuash, problematikës që ka pasur siguria publike në vend.

Është e nevojshme që ta zgjerojmë këtë njësi, sepse ne e shikojmë që problematikat janë shumë të mëdha për sigurinë individuale dhe për atë publike dhe nuk është se i përgjigjen të gjithë në këtë drejtim. Pra, ne po flasim për sigurinë e individit nga kriminaliteti, por individi tashmë nuk rrezikohet vetëm nga kriminaliteti, por edhe nga shumë faktorë të tjerë, si ai mjedisor, ushqimor, siguria në rrugë e të tjera, që nuk kemi pasur mundësi t'i analizojmë.

Duke u nisur nga fakti që gjatë këtij viti kanë ndodhur shumë aksidente, vendosëm që një nga konferencat që kemi në muajin maj, ta bëjmë lidhur me këtë çështje, për aksidentet në vendin tonë gjatë 20 vjetëve të fundit, për të nxjerrë të gjithë problematikën dhe për të rekomanduar pastaj edhe se si duhet të ndryshojnë politikat.

Ermonela Felaj – Faleminderit zotit Brahimllari, për pyetjet, dhe zotit Mema, që na dha mundësinë e kësaj përgjigjeje!

Besoj se kam mbështetjen e të gjithë kolegëve, që ky diskutim na jep shkak të kuptojmë se me Akademinë e Sigurisë duhet konsultuar më shpesh kur ka propozime që lidhen me legjislacionin penal, ose në përgjithësi me legjislacionin që ka të bëjë me rendin dhe sigurinë, në mënyrë që edhe ato studime që bëjnë ekspertët, ose ekspertiza e huaj t'i vlejnë edhe Komisionit parlamentar të Sigurisë dhe të gjejnë dritë, të mos ngelen në sirtar dhe të materializohen diku.

Ka pyetje të tjera nga kolegët, apo do të kalojmë në diskutim?

Mbyllim pyetjet dhe kalojmë në diskutim. Mbi bazën e të gjitha përgjigjeve dhe prezantimit që u bë këtu pak më parë, fjala është për zotin Noka.

Flamur Noka – Zoti Drejtor, jeni munduar që keni ardhur në këtë komision! Ju jeni titullar policie dhe duhet të vinit këtu detyrimisht i shoqëruar me një autoritet politik, sepse kjo është Rregullorja e Kuvendit, kështu është ligji. Megjithatë, kjo është tjetër gjë.

Ne e kuptojmë shumë mirë frikën që kanë titullarët politikë të Ministrisë së Brendshme për t'u ballafaquar me realitetin që ndodh sot, të cilët sjellin titullarë teknikë për ta futur këtë komision në ngërçin e icklave teknike dhe burokratike. Por tentativa për të mbuluar bëmat dhe gjëmat e kësaj qeverie dhe të Ministrisë së Brendshme, tentativa për të

mbuluar katandisjen e Policisë së Shtetit duke sjellë këtu artifica për makijazh fals, duke sajuar dhe improvizuar skena të tilla, në fakt, më shumë se gjithçka tjetër tregon lëngimin dhe gjendjen e rëndë në të cilën është katandisur në këto vite të “Rilindjes”, institucioni i Policisë së Shtetit.

Sot në stemën e Policisë së Shtetit nuk është më simboli që ka pasur, sot “Rilindja” këtë stemë e ka zëvendësuar me stemën e lules së hashashit; sot flamuri i Policisë së Shtetit është i njollosur dhe i zhubravitur me fijet e krimit të organizuar shqiptar; sot për fat të keq, Policia e Shtetit ka fytyrën e Sajmir Tahirit; sot për fat të keq, Policia e Shtetit nën qeverisjen e Edi Ramës, ka fytyrën e Geron Xhafajt; sot për fat të keq, Policia e Shtetit ka fytyrën e Habilajve, ka fytyrën e Balilit; sot për fat të keq, Policia e Shtetit ka si simbolin e saj Jael Çelën, Gjergj Koilën dhe disa trafikantë të tjerë që ka pasur në drejtimin e Policisë së Shtetit.

Nuk është asgjë rastësore, droga në këtë vend erdhi si pasojë e një vullneti politik, sepse Kryeministri ishte adhurues e përdorues i saj, ndaj Shqipëria u zhyt në drogë; ndaj Shqipëria u kthye në Kolumbinë e Europës; ndaj Shqipëria po kthehet në Meksikë për sa u përket përplasjeve të hesapeve të drogës, sot e kësaj dite.

Nuk është rastësor as inkriminimi i Policisë së Shtetit, sot ajo lëngon tmerrësisht nga inkriminimi masiv që i është bërë. Edhe futja e elementëve të inkriminuar, të larguar, edhe nga ju që keni qenë në qeverisjen e kaluar të socialistëve, edhe sipas rekomandimit të Ambasadës së SHBA-së, nuk është rastësi, por është vullnet politik, sepse Kryeministri adhuron krimin e organizuar dhe kriminelët. Ata, ai nuk i quan kriminelë, por i quan biznesmenë të mëdhenj, ndaj edhe sot, ata realisht janë biznesmenët më të mëdhenj në këtë vend.

Pra, e gjithë çështja e inkriminimit të policisë është pasojë e mendësisë dhe filozofisë qeverisëse dhe nuk është rastësi.

Edhe ngjarja e Malësisë së Madhe nuk është rastësi, sepse sot shqiptarët në imazhin e atij oficeri bandit, shohin fytyrën e Lleshajt dhe të Kryeministrit Edi Rama. Ata janë shëmbëlltyra. Ajo ngjarje dhe dhjetëra të tjera si ajo, që për fat të keq fshihen dhe mbulojnë me urdhra politikë edhe perversitete të tilla, janë produkt i një teorie induksioni të perversitetit që qarkullon në qeverinë shqiptare. Perversiteti ka mbuluar Kryeministrin, ministrat, sigurisht induktohet poshtë dhe perversët, kudo që janë, ngrenë krye.

Nuk është rastësore, ndaj ka vetëm një zgjidhje, dhe zgjidhja është vullneti politik tashmë jo thjesht i forcave politike. Ky vullnet tashmë ka kaluar dhe do të kalojë edhe në duart e qytetarëve në datën 16, sepse shqiptarët kanë nevojë që në këtë vend të ketë shtet dhe

të bëhet shtet dhe jo të qeverisin bandat; shqiptarët kanë nevojë që ky vend të ketë Polici të Shtetit dhe të ligjit dhe jo polici të bandave dhe të drogës; shqiptarët kanë nevojë që ky vend të mos jetë i mbushur me hashash, kokainë dhe heroinë, por të jetë i mbushur me zhvillim; ky vend të prosperojë dhe evoluojë drejt Europës; shqiptarët kanë nevojë t'u kthehet shpresa dhe e ardhmja.

Ky mesazh do të jepet vetëm në një ditë dhe këtë s'do ta bëjë asnjë forcë politike, por vetë qytetarët dhe ne si opozitë do të jemi të detyruar t'i mbështesim ata për ta fshirë e pastruar këtë ngrehinë kriminale që, për fat të keq, etiketohet shtet dhe pushtet në Shqipëri. 16 shkurti do të jetë dita kur do t'i pastrojë të gjitha këto mbetje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Meqenëse një pjesë e kolegëve, i ezauruan diskutimet bashkë me pyetjet, më lejoni të kem edhe unë të drejtën time për të bërë diskutimin e fundit në këtë komision.

Faleminderit zoti Mema dhe zoti Rica, që ishit të pranishëm në komision! Ju na dhatë rastin të kuptojmë diferencën e arsimit të mirë dhe vërtetësinë e shprehjes “Arsimi i keq, është rrënja e të gjitha të këqijave”. 10 vjet Akademi e mbyllur, ku 3 vjet shkollë u zëvendësuan me kurse, natyrisht që e kanë dhënë pasojën e tyre. Më vjen mirë që ngeleni besimplotë se do të arrini të rikuperoni në kohë të gjitha humbjet që na ka krijuar vendimi i pamend i asaj kohe, që çoi drejt mbylljes së Akademisë së Sigurisë.

Nga ana tjetër, e gjej me vend që kjo seancë t'i ketë shërbyer publikut dhe të gjithë atyre që aspirojnë për t'u bërë pjesë e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit është një organizatë e madhe, janë 13 mijë vetë, që kurrësi nuk mund të identifikohen me njerëz që devijojnë nga rruga e ligjit dhe e moralit.

Më vjen keq, zoti Noka, por ju sapo keni humbur 13 mijë votues potencialë, sepse, natyrisht, janë të depolitizuar, por kanë të drejtë zgjedhjeje; sapo keni humbur 704 studentë; sapo keni humbur edhe 400 aplikues, sepse, fatkeqësisht, ju ata i barazuat me perversët. Ne perverësve u tregojmë vendin, i arrestojmë. Ju nuk e keni bërë këtë gjë.

Flamur Noka – Ju i bëni kryeministra perversët, ministra, drejtorë, titullarë!

Ermonela Felaj – Kryetari juaj i Bashkisë së Kamzës vazhdon të jetë atje, ish-ministri juaj i njohur për mbërtheqat nuk u arrestua kurrë dhe arriti të shpëtojë pa lagur. Kjo është diferenca mes jush e nesh...

Flamur Noka – Ju bëni filma me përdhunime...

Ermonela Felaj – Nuk ia mbushni dot mendjen publikut për këto, sepse ai na ka para syve çdo ditë dhe e bën shumë qartë diferencën, siç e ka bërë në çdo zgjedhje.

Unë nuk ju ndërhyra, fakti që ju po ndërhyni dhe nervoziteti juaj tregojnë se sforcoheni për ta bërë gjithë këtë diskutim.

Nuk dua ta zgjas kolegë, sepse dua të respektoj nivelin teknik që kishim ftuar sot, duke ju uruar punë dhe ditë të mbarë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA